



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E SHTIMES

MUNICIPALITY OF SHTIME/ OPSTINA STIMLJE

ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

/KANCELARIJA PRESEDNIKA OPSTINE/MAYOR'S OFFICE

ZYRA PËR INFORMIM/ INFORMATION OFFICE/ KANCELARIJA ZA  
INFORMISANJE

Data/Datum/Date:	16. 1. 2025
Nr./Br./No	02/28
Për/Za/To:	Kuvendin e Komunës së Shtimes-kryesuesi Adnan Ademi
Përmes/Preko/Through:	z. Qemajl Aliu, kryetar i Komunës së Shtimes
Nga/Od/From:	Vlora Hyseni, kordinatore e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi
Lënda/Predmet/Subject:	Informatë për punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2024

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) në Komunën e Shtimes ka zhvilluar gjashtë mbledhjet e parapara gjatë vitit 2024, me qëllim sigurimin e një mjedisi të qetë dhe stabil për qytetarët e kësaj komune. Bashkëpunimi mes institucioneve dhe qytetarëve ka qenë faktor kyç për përmirësimin e cilësisë së jetës.

Raporti është bazuar në Strategjinë dhe Planin e Veprimit si dhe Planit Vjetor te Punës dhe përbledh temat kryesore të trajtuar në gjashtë mbledhjet e mbajtura gjatë vitit 2024.

**Me vendim të Kryetarit të Komunës së Shtimes z. Qemajl Aliut për themelimin e KKSB në Shtime me nr:prot 02/65 dt: 7.02.2024 më dt: 13.02.2024 është caktuar mbledhja e parë e KKSB, që kishte këtë rend dite:**

Mbledhja u hap me konstatimin e listës së anëtarëve të pranishëm. U sigurua kuorumi i nevojshëm për vazhdimin e punës dhe mbledhja vijoi sipas rendit të ditës.

1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 12 dhjetor 2023;

Prosesverbal i mbledhjes së mbajtur më 12 dhjetor 2023 u shqyrtua dhe u hodh në votim. Anëtarët e KKSB-së e miratuan pa asnje vërejtje.

**2. Informatë mbi Çështjet e Sigurisë në Komunën e Shtimes nga policia e Kosovës:**

Komandanti i Stacionit Policor në Shtime, Haxhi Behluli, prezantoi një raport mbi situatën aktuale të sigurisë në komunë. Në raport u theksuan: Aktivitetet kryesore të realizuara gjatë periudhës së fundit. Sfidat me të cilat janë përballur autoritetet poliore. Rëndësia e bashkëpunimit mes institucioneve lokale për krijimin e një mjedisi më të sigurt për qytetarët.

**3. Informatë nga Njësia Profesionale për Zjarrfikje dhe Shpëtim:**

Për shkak të mungesës së përfaqësuesit të Njësisë Profesionale për Zjarrfikje dhe Shpëtim, pika e tretë e rendit të ditës u vendos të shtyhet për mbledhjen e ardhshme.

**4. Të Ndryshme:**

Kryetari i Këshillit të Prindërve, Xhavit Bungu, ngriti çështje lidhur me sigurinë në shkollat e komunës. Diskutimi përfshiu: Shqetësimet e prindërve mbi sigurinë e nxënësve dhe mësimdhënësve. Nevojën për masa konkrete për përmirësimin e mjedisit shkollor.

Propozimet dhe rekomandimet: Intensifikimi i bashkëpunimit mes Policisë së Kosovës dhe institucioneve komunale për përmirësimin e sigurisë. Planifikimi i masave shtesë për rritjen e sigurisë në shkolla në bashkëpunim me këshillin e prindërve, stafin arsimor dhe njesinë poliore në Shtime.

**Mbledhja e dytë e KKSB-së, është mbajtur më 25 prill 2024, dhe kishte këtë rend dite:**

Mbledhja u hap nga nënkyetari i Komunës së Shtimes, Faruk Beqa. Ai prezantoi rendin e ditës dhe udhëhoqi shqyrtimin e procesverbalit të mbledhjes së mëparshme të mbajtur më 23 shkurt 2024.

1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 23 shkurt 2024;

Prosesverbalit u shqyrtua dhe u aprovua pa komente të tjera nga anëtarët e pranishëm.

2. Informatë për çështje të sigurisë në komunën e Shtimes nga Policia e Kosovës;

Komandanti i Stacionit Policor në Shtime raportoi për gjendjen e sigurisë në komunë, duke theksuar se situata është nën kontroll. Ai rekomandoi rritjen e bashkëpunimit mes Policisë dhe qytetarëve për t'u përballur më mirë me sfidat lokale.

3. Informatë nga Njësia Profesionale për Zjarrfikje dhe Shpëtim në Shtime;

Pika e tretë e rendit të ditës u vendos të shtyhet për mbledhjen e ardhshme.

4. Informatë nga Drejtoria për Shërbime Publike;

Zyrtarja Albulenë Emini prezantoi informata për menaxhimin e mbeturinave dhe inspektimet e kryera në terren. Ajo theksoi disa sfida të lidhura me trajtimin e mbeturinave dhe nënvizoin rëndësinë e ndërgjegjësimit publik për këtë çështje.

## 5.Të Ndryshme;

Gjatë kësaj pike, u diskutuan tema të ndryshme të interesit publik, përfshirë përpjekjet për përmirësimin e sigurisë dhe të shërbimeve komunale.

Mbledhja përfundoi me konstatimin se duhet të forcohet koordinimi ndërinstitucional për të adresuar sfidat e sigurisë dhe ato publike në komunën e Shtimes. U theksua rëndësia e angazhimit të vazhdueshëm të të gjitha palëve për përmirësimin e situatës.

**Më 26 qershor 2024, është mbajtur mbledhja e tretë e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), ku u diskutuan çështje të ndryshme të rëndësishme për komunën e Shtimes.**

Mbledhja u zhvillua sipas rendit të ditës si vijon:

1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 25 prill 2024:

Në këtë pikë, anëtarët e KKSB-së shqyrtuan dhe aprovuan procesverbalin e mbledhjes së kaluar.

2. Informatë për çështje të sigurisë në komunën e Shtimes nga Policia e Kosovës:

Komandanti i Stacionit Policor në Shtime raportoi mbi gjendjen e sigurisë në komunë, duke theksuar se situata është e stabilizuar dhe nën kontroll, pa ndonjë incident të madh që mund të shqetësojë komunitetin.

3. Informatë nga Njësia Profesionale për Zjarrfikje dhe Shpëtim në Shtime:

Komandanti i Njësisë Profesionale për Zjarrfikje dhe Shpëtim, Bajram Gashi, informoi të pranishmit mbi përgatitjet e njësisë për sezonin veror, përfshirë zhvillimet dhe planet për parandalimin e zjarreve në periudhën e ngarkuar.

4. Informatë nga Drejtoria e Arsimit:

Shefi i Zyrës së Arsimit, Lulzim Sahiti, prezantoi një raport të detauar mbi punën dhe aktivitetet e Drejtorisë Komunale të Arsimit për periudhën 1 janar - 30 qershor 2024. Ai theksoi angazhimin e drejtorisë në përmirësimin e kushteve arsimore dhe arritjen e objektivave për këtë gjashtëmuajor.

5. Të ndryshme:

Gjatë diskutimeve të kësaj pike, anëtarët trajtuan çështje të tjera që prekin qytetarët e komunës, duke përfshirë temat e përditshme dhe shqetësimet që ndikojnë drejtpërdrejtë në mirëqenien e komunitetit. Mbledhja e tretë e KKSB-së u karakterizua nga diskutime konstruktive dhe informime të detauara mbi fushat përkatëse, duke kontribuar në transparencë dhe bashkëpunim të mirë mes institucioneve dhe qytetarëve.

**Më 24 shtator 2024, u mbajt mbledhja e katërt e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) në Komunën e Shtimes.**

Në këtë mbledhje, u diskutuan çështje të rëndësishme bazuar në rendin e ditës si më poshtë:

1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Mbledhja filloi me shqyrtimin dhe miratimin e Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 26 qershor 2024.

2. Informatë për gjendjen e sigurisë në Komunën e Shtimes.

Komandanti i Stacionit të Policisë në Shtime, Haxhi Beçluli, raportoi për gjendjen e sigurisë në komunë, duke theksuar se situata është cilësuar e qetë dhe stabile. Janë prezantuar rastet e ndodhura gjatë periudhës së fundit, të cilat janë trajtuar nga autoritetet përkatëse.

3. Informatë nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Besnik Ahmeti, informoi anëtarët e KKSB-së për procesin e dëgjimeve buxhetore dhe kërkesat e qytetarëve gjatë këtyre dëgjimeve. Ai ndau detaje mbi menaxhimin financier dhe priorititetet e komunës për periudhën në vijim.

4. Diskutim për Parandalimin e Ekstremizmit.

Gjatë diskutimit për parandalimin e ekstremizmit, anëtarët e KKSB-së shprehën shqetësimet për përhapjen e tij. Kryetari i KBI-së në Shtime, Skender Baftiu, vlerësoi se gjendja është stabile dhe e menaxhueshme, përvèç disa lëvizjeve të fundit nga një grup i njohur si "Lëvizja e Deçanit", i cili synon të nxisë urrejtje fetare. Këshilli diskutoi hapat që duhen ndërmarrë për parandalimin e këtyre fenomeneve.

5. Portalet që sjellin lajme të rrejshme dhe pasojnë te publiku.

Të pranishmit ngritën shqetësime për ndikimin negativ të portaleve që publikojnë lajme të rreme. Sipas të pranishmve, këto portale shpesh nuk kanë identitet të qartë dhe përhapin informacione të pavërteta, duke ndikuar negativisht te opinioni publik. Komandanti i Stacionit Policor në Shtime sqaroi se rastet e raportuara nga qytetarët për lajmet e rrejshme janë duke u trajtuar nga njësitet përkatëse.

6. Të ndryshme.

Në pikën e fundit, të pranishmit trajtuan çështje të tjera të ndryshme, duke theksuar rëndësinë e vazhdimit të bashkëpunimit përfundimtar për forcimin e sigurisë dhe mirëqenies në komunë.

Mbledhja përfundoi me një angazhim të përbashkët përfundimtar për zgjidhjen e sfidave dhe ruajtjen e sigurisë në komunë.

**Mbledhja e pestë e Këshillit Komunal për Siguri në Flashkësi (KKSB) u mbajt më datën 23 tetor 2024.** Gjatë kësaj mbledhjeje, u shqyrtuan disa çështje të rëndësishme lidhur me sigurinë në Komunën e Shtimes.

Rendi i Ditës:

1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 24 shtator 2024:

U miratua procesverbal i mbledhjes së kaluar, pa ndonjë ndryshim.

2. Informatë për çështje të sigurisë në komunën e Shtimes nga Policia e Kosovës:

Komandanti i Stacionit Policor në Shtime, informoi anëtarët e KKSBS-së për gjendjen e sigurisë në komunë, e cila, krasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, u vlerësua më stabile dhe e qetë. Policia e Kosovës vazhdon të monitorojë dhe ndërmarrë masa për parandalimin e krimeve dhe mbajtjen e rendit në qytet.

3. Luftimi i narkomanisë në shkolla dhe hapësira publike:

Sipas përfaqëuesve të policisë, në lidhje me këtë temë nuk ka asnjë të dhënë zyrtare të paraqitur për narkomani në komunën tonë.

4. Zbatimi i masave për sigurinë në punë:

U diskutua për masat që duhet të ndërmerren për të siguruar kushte të sigurta pune në institucione dhe ndërmarrje, duke theksuar rëndësinë e kontrollit dhe edukatës për sigurinë në punë.

5. Të ndryshme:

Në këtë pikë, u diskutuan shqetësime të ndryshme të qytetarëve të Komunës së Shtimes.

Mbledhja u mbyll me angazhimin e anëtarëve të KKSBS-së për të vazduar punën në ruajtjen e sigurisë dhe zhvillimin e një mjeti më të sigurt për qytetarët e Komunës së Shtimes.

**Më 23 dhjetor 2024, u mbajt mbledhja e gjashtë dhe e fundit për këtë vit e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBS) në Komunën e Shtimes.**

Mbledhja u zhvillua sipas rendit të ditës së përcaktuar dhe trajtoi disa çështje me rëndësi për sigurinë dhe mirëqenien e qytetarëve.

Rendi i Ditës dhe Diskutimet

1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 23.10.2024

Procesverbal i mbledhjes së kaluar u shqyrtua dhe u miratua nga anëtarët e KKSBS-së pa ndonjë vërejtje.

2. Informatë për çështje të sigurisë në Komunën e Shtimes nga Policia e Kosovës

Komandanti i Stacionit Policor, Haxhi Behluli, prezantoi një raport mbi gjendjen e sigurisë në komunë, duke e vlerësuar atë si mjaft stabile. Ai bazohej në statistikat e raportit 11-mujor të vitit 2024 dhe prezantoi masat e ndërmarra për parandalimin e dhunës në familje, duke theksuar përkushtimin e Policisë së Kosovës për të ruajtur sigurinë publike.

### 3. Parandalimi i dhunës në familje

Në këtë pikë, u diskutuan mekanizmat dhe masat e mundshme për të parandaluar dhunën në familje. U përmend nevoja për ndërgjegjësim më të madh të qytetarëve dhe për forcimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve relevante.

### 4. Kontrolli, shpërndarja dhe ndalesat për mjetet piroteknike

Drejtori i Drejtorisë së Inspektoratit, Bardhyl Rushiti, informoi mbi urdhèresën që është nxjerrë për kontrollin dhe ndalimin e shpërndarjes së mjeteve piroteknike. Ai theksoi rëndësinë e ndërgjegjësimit të qytetarëve për rrezikun që paraqesin këto mjete, veçanërisht gjatë festave të fundvitit.

### 5. Raport nga QKMF “Dr. Vezir Bajrami”,

Drejtori i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, Ilaz Kadrijaj, prezantoi një raport mbi aktivitetet dhe shërbimet e QKMF-së gjatë vitit 2024. Ai informoi për numrin e vizitave mjekësore dhe shërbimet e ofruara, duke vlerësuar përkushtimin e stafit në përbushjen e nevojave shëndetësore të qytetarëve.

### 6. Të ndryshme

Në këtë pikë, anëtarët e KKSB-së diskutuan tema të ndryshme, duke përfshirë rekomandimet për përmirësimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe përgatitjet për sfidat e vitit të ardhshëm.

Mbledhja përfundoi me mirënjojje për angazhimin e institucioneve gjatë vitit 2024 dhe me një thirje për përkushtim të vazhdueshëm për sigurinë dhe mirëqenien e qytetarëve në vitin e ardhshëm. KKSB mbetet e përkushtuar për të adresuar në kohë sfidat dhe për të ofruar zgjidhje efektive për komunitetin.

### Sfidat dhe Shqetësimet

Komuna e Shtimes, përmes punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), ka trajtuar sfida të shumta në drejtim të përmirësimit të sigurisë dhe mirëqenies së qytetarëve. Në mbledhjet e rregullta të KKSB-së janë evidentuar disa prej shqetësimeve kryesore:

1. Parandalimi i dhunës në familje: Dhuna në familje mbetet një problematikë serioze. KKSB, ka propozuar ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe përforcimin e mekanizmave institucionalë për parandalimin dhe trajtimin e rasteve.
2. Trajtimi i mbeturinave dhe ndotja mjedisore: Sfida të mëdha mbeten në menaxhimin e mbeturinave dhe përmirësimin e higjenës publike. Nevojitet rritje e ndërgjegjësimit publik dhe investime në këtë sektor.
3. Ekstremizmi dhe lajmet e rreme: Këshilli ka diskutuar shqetësimet për përhapjen e ekstremizmit dhe ndikimin negativ të portaleve me lajme të pavërteta, duke theksuar nevojnë për veprime parandaluese dhe informim të saktë të publikut.

4. Rreziku nga mjetet piroteknicë: Për shkak të përdorimit të pakontrolluar të mjeteve piroteknicë, janë ndërmarrë masa për ndalimin dhe kontrollin e shpërndarjes së tyre, veçanërisht gjatë festave.

Të gjitha mbledhjet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, janë udhëhequr nga nënkyetari i Komunës së Shtimes, Faruk Beqa, i cili ka luajtur një rol kyç në zhvillimin dhe funksionimin e këtij këshilli.

Ndërsa vlen të ceket që sipas monitoruesve të KKSBB-së, Komuna e Shtimes spikat si një shembull i mirë për komunat tjera në Kosovë, jo vetëm për mënyrën e organizimit të mbledhjeve, por edhe për qasjen konstruktive ndaj vendimeve dhe kërkesave të trajtuarë. Ky angazhim reflekton seriozitetin dhe përgjegjësinë institucionale të Komunës së Shtimes për të përmirësuar sigurinë dhe mirëqenien e qytetarëve të saj.

Përmes bashkëpunimit të ngushtë mes institucioneve dhe qytetarëve, si dhe fokusit në zbatimin e vendimeve të marra, Komuna e Shtimes vazhdon të dëshmojë se puna e koordinuar mund të sjellë rezultate konkrete dhe të prekshme për qytetarët.

Më gjerësisht diskutimet mundë të gjinden edhe në proceverbalet e mbledhjeve, të publikuara në webfaqen zyrtare të Komunës së Shtimes.